

Prishtinë, 31 maj 2007
Kodi i ZRRE-së: D_51_2007

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Mandatin ligjor që i jepet në Nenet 45 deri në 48 të Ligjit Nr. 2004/09 "Mbi Rregullatorin e Energjisë";
2. Dispozitat e Rregullit mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike ("Rregulla e Çmimeve"), nxjerrë nga Bordi i ZRRE-së më 15/12/2005, dhe në veçanti pikat 30.2 a) & b) të rregullit të sipërpërmendur;
3. Dispozitat e Metodologjisë së Tarifave të nxjerrë nga Bordi i ZRRE-së më 15/12/2005;
4. Të dhënat e reja të dërguara nga KOSTT Sh.a lidhur me zvogëlimin e kostove aktuale për vitin 2007 nën ato të lejuara, sipas Vendimit D_29_2006 të datës 21/12/2006 mbi "Të hyrat e Lejuara për KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a për periudhën e rishqyrtimit të çmimeve 2007-2009".
5. Vendimin D_47_2007 të datës 07/05/2007, lidhur me këto të dhëna, për rishqyrtimin e të hyrave të lejuara për KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a të miratuara në Vendimin D_29_2006;
6. Nevojën që ka pasuar që të rishqyrtohet gjithashtu edhe Vendimi D_41_2007 i datës 15/03/2007 "Mbi miratimin e tarifave të transmisionit për KOSTT Sh.a";
7. Komentet e pranuar gjatë rishqyrtimit, duke përfshirë propozimet e parashtruara nga KOSTT Sh.a për ndryshimin e tarifave të transmisionit të aprovuara, si dhe qëndrimin e ZRRE-së për këto propozime.

Bordi i ZRRE-së në Sesionin e mbajtur me 31 maj 2007, ka vendosur të:

1. Ndryshojë Vendimin D_29_2006 të datës 21/12/2006 "mbi "Të hyrat e Lejuara për KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a për periudhën e rishqyrtimit të çmimeve 2007-2009" siç shihet në tabelën më poshtë, për të përshtatur të hyrat e lejuara për KOSTT Sh.a, që do të marrë parasysh të dhënat e reja mbi kostot aktuale të reduktuara të ofruara nga këto kompani:

Tabela 1: Të hyrat e lejuara të ndryshuara për KOSTT Sh.a, 2007

<i>EUR 000</i>	<i>Miraturar (21 dhjetor 2006)</i>	<i>të ndryshuara</i>
Të hyrat e lejuara që duhet të mbulohen	13 678	13 190

nga tarifât e transmisionit për vitin 2007		
--	--	--

2. Në përputhje me rrethanat, ndryshohet Vendimi D_41_2007 i datës 15/03/2007 “Mbi Aprovimin e Tarifave të Transmisionit për KOSTT Sh.a-në” për të miratuar tarifât e transmisionit si vijojnë në Tabelën 2:

Tabela 2: Tarifât e transmisionit të ndryshuara për KOSTT Sh.a

Tarifât	Njësia	Miratuar (15 mars 2007)	të ndryshuara
Tarifa për rrjete			
- 400/220kV	EUR / kW / vit ^a	3.119	3.025
- 110kV	EUR / kW / vit ^b	7.001	6.792
Tarifa për operim të sistemit	EUR / MWh	0.872	0.849
Tarifa për operim të tregut	EUR / MWh	0.013	0.014

a Aplikohet për mesataren e nevojës në kohën e pesë nevojave më të larta maksimale të sistemit në vit. Vetëm furnizuesve ju lejohet kjo ngarkesë.

b Përfshin ngarkesën prej 400/220kV

- Tarifât e transmisionit do të zbatohen nga data 1 maj 2007 për KOSTT Sh.a, parashihet mundësia që pas 31 dhjetorit 2007, për pajtueshmëri ndërmjet shumëve që aktualisht merren nga konsumatorët e KOSTT Sh.a, nga KEK Sh.a dhe nga klientët e tjerë, dhe atyre që do të merreshin nëse tarifât e reja do të hynin në fuqi nga data 1 prill 2007, dhe ndryshimi t’ju shtohet apo t’ju zbritet konsumatorëve të KOSTT Sh.a, gjatë vitit 2008, në mënyrë që të propozohet nga KOSTT Sh.a dhe miratohet nga ZRRE-ja.
- Ky Vendim duhet të publikohet nga KOSTT Sh.a. brenda 5 ditëve të punës, së paku në një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë, pas njoftimit të ZRRE-së dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të saj.
- Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- Ky Vendim do të zbatohet nga data 1 maj 2007.

Mbështetja për këtë vendim është dhënë në letërën përcjellëse (Rishqyrtimi i vendimeve D_29_2006, D_39_2007 dhe D_41_2007).

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti
Kryesues

Theranda Beqiri
Anëtare

Nysret Avdiu
Anëtar

Merita Kostari
Anëtare

Naim Bejtullahu
Anëtar

Kopje:

*Kryetarit të Kuvendit;
Kryeministrit;
MEM-it;
ZPSSP Shtyllës së IV;
Zyrës për Politikë Ekonomike/Shtylla e IV;
Zyra Ligjore / Shtylla e IV;
KOSTT Sh.a
MEF-it;
Zyrës për Çështje Fiskale / Shtylla e IV;*